

VENDIM
Nr.53, datë 3.8.2009

**PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “EFT ALBANIA” SHPK NË AKTIVITETIN E
TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 13, pikat 1, germa “d”, dhe 8 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, dhe neneve 4, germa “g”, 5, 13 dhe 14 të “Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë /të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 3.8.2009, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “EFT Albania” sh.p.k., për licencim në aktivitetin e tregtimit të energjise elektrike,

dhe konstatoi se:

- Fillimi i procedurave për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “EFT Albania” sh.p.k. ka nisur me marrjen e vendimit nr.36, datë 7.5.2009.

- Dokumentacioni për aplikimin për licencimin, për kryerjen e aktivitetit të tregtimit të energjisë elektrike është paraqitur i plotë konform përcaktimeve të “Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/pjesshëm dhe rinovimit të licencave”.

Për gjithë sa më sipërcituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “EFT Albania” sh.p.k. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike me afat të vlefshmërisë së licencës 5 vjet.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut ta njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta